



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurorja e Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 12 shtator 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Selimit në lidhje me Seancën Përgatitore të W04846-ës dhe Kërkesën e Mbrojtjes së Selimit për Tërheqje të Vërejtjes ZPS-së dhe për Masa Shtesë

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21 dhe 40(2) dhe (6)(h) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 116(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 14 dhjetor 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") përfshiu W04846-ën në listën e dëshmitarëve të planifikuar për të dhënë dëshmi në periudhën 15 janar - 4 prill 2024.¹

2. Më 18 qershor 2024, Trupi Gjykues lëshoi vendimin mbi kërkesën e përbashkët të Mbrojtjes për ndryshimin e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit ("Urdhri"), me të cilin hodhi poshtë disa ndryshime që ishin propozuar t'i bëheshin Urdhrit ("Vendimi").²

3. Më 19 qershor 2024, Trupi Gjykues lëshoi Vendimin mbi Mocionin e Mbrojtjes së Selimit për Përrjashtimin e Provave të W04846-ës ("Vendimi i Dytë").³ Trupi Gjykues urdhëroi ZPS-në që të mos merrte prova nga W04846 në lidhje me dy pretendime që kanë të bëjnë me Rexhep Selimin ("z. Selimi"), konkretisht: (i) vrasjen e pretenduar të një personi ("pretendimi i parë"); dhe (ii) rrahjen dhe vrasjen e pretenduar të një personi tjetër ("pretendimi i dytë") (bashkërisht "pretendimet"), dhe udhëzoi ZPS-në që ta paralajmëronte W04846-ën të mos dëshmonte vullnetarisht në lidhje me pretendimet.⁴

¹ F02007/A01, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim prej Prokurorisë i Listës së Dëshmitarëve për Periudhën 15 Janar – 4 Prill 2024*, 14 dhjetor 2023, konfidencial, f. 50.

² F02389, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Ndryshimin e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 18 qershor 2024.

³ F02393, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes së Selimit për Përrjashtimin e Provave të W04846-ës*, 19 qershor 2024, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F02393/RED).

⁴ Vendimi i Dytë, para. 24, 29, 31.

4. Më 20 qershor 2024, Mbrojtja e z. Selimi ("Mbrojtja e Selimit") dorëzoi kërkesë urgjente në lidhje me seancën përgatitore të W04846-ës, që ishte planifikuar të fillonte të nesërmen ("Kërkesa e Parë").⁵
5. Më 21 qershor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") iu përgjigj Kërkesës së Parë ("Përgjigjja e Parë").⁶
6. Më 21 qershor 2024, Trupi Gjykses informoi palët dhe pjesëmarrësit se kishte marrë Kërkesën e Parë dhe nuk e shihte të nevojshme të ndërmernte veprime në atë fazë, dhe se seanca përgatitore me dëshmitarin duhej të vijonte siç ishte planifikuar.⁷
7. Më 24 qershor 2024, Mbrojtja e Selimit dorëzoi një kërkesë të dytë në lidhje me seancën përgatitore të W04846-ës ("Kërkesa e Dytë").⁸
8. Më 25 qershor 2024, ZPS-ja iu përgjigj Kërkesës së Dytë ("Përgjigjja e Dytë").⁹
9. Më 26 qershor 2024, W04846 dha dëshmi në këtë proces gjyqësor.¹⁰
10. Më 26 qershor 2024, Trupi Gjykses lëshoi urdhër gojor me të cilin rrëzoi Kërkesën e Parë dhe Kërkesën e Dytë, duke theksuar se vendimi i arsyetuar do të lëshohej më vonë.¹¹ Trupi Gjykses lëshon në vijim vendimin e arsyetuar të tij.

⁵ F02397, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë Urgjente e Mbrojtjes së Selimit në lidhje me Seancën Përgatitore të W04846-ës*, 20 qershor 2024, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 24 qershor 2024, F02397/RED).

⁶ F02398, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje Urgjente e Prokurorisë ndaj Kërkesës Urgjente të Mbrojtjes së Selimit në lidhje me Seancën Përgatitore të W04846-ës*, 21 qershor 2024, konfidenciale.

⁷ CRSPD572, *Mesazh Elektronik nga Trupi Gjykses II drejtuar Palëve dhe Pjesëmarrësve*, 21 qershor 2024, konfidencial.

⁸ F02404, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Selimit për Tërheqje të Vërejtjes ZPS-së dhe për Masa Shtesë*, 24 qershor 2024, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 9 korrik 2024, F02404/RED).

⁹ F02405, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Selimit për Tërheqje të Vërejtjes ZPS-së dhe për Masa Shtesë*, 25 qershor 2024, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 27 qershor 2024, F02405/RED).

¹⁰ Transkripti i seancës, 26 qershor 2024, konfidencial, f. 17256-17324.

¹¹ Transkripti i seancës, 26 qershor 2024, konfidencial, f. 17252, rreshti 19 deri në f. 17253, rreshti 15.

II. PARASHTRIMET

A. KËRKESA E PARË DHE PËRGJIGJJA E PARË

11. Në Kërkesën e Parë, Mbrojtja e Selimit i kërkoi Trupit Gjykses të lëshonte një urdhër për ZPS-në, ku ta urdhëronte: (i) të mos diskutonte me W04846-ën e as t'i tregonte deklaratat e mëparshme të tij që nuk ishin përfshirë në listën e provave materiale të ZPS-së ("lista e provave materiale"); (ii) t'i jepte W04846-ës versionet e deklaratave të mëparshme të tij të përfshira në listën e provave materiale, me redaktimet e bëra në provat e përjashtuara në Vendimin e Dytë; dhe (iii) të kryente seancën përgatitore me W04846-ën në përputhje me masat e përcaktuara në paragrafët (i) dhe (ii) deri në marrjen e vendimit mbi Kërkesën e Parë.¹² Sipas Mbrojtjes së Selimit, kjo ishte e domosdoshme pasi ZPS-ja kishte njoftuar se gjatë seancës përgatitore do t'i jepte W04846-ës: (i) deklaratat e mëparshme të tij si dëshmitar që nuk janë në listën e provave materiale; dhe (ii) deklaratat e mëparshme të tij si dëshmitar që janë në listën e provave materiale, por pa redaktimet në pjesët që Trupi Gjykses përjashtoi në Vendimin e Dytë. Kjo, sipas Mbrojtjes së Selimit, binte ndesh me Urdhrin, Vendimin dhe Vendimin e Dytë.¹³

12. ZPS-ja u përgjigj se Trupi Gjykses duhej ta rrëzonte Kërkesën e Parë.¹⁴ ZPS-ja theksoi se, në përputhje me paragrafin 97(iii) të Urdhrit, "gjatë seancave përgatitore, avokati që parashtron pyetje duhet: [...] t'i japë dëshmitarit mundësinë t'i shikojë deklaratat e mëparshme të veta".¹⁵ ZPS-ja shtoi se leje për të përfshirë materiale - ndër të cilat deklarata të mëparshme - në listën e provave, duhet të kërkojë vetëm kur parashikon që ato materiale mund të përdoren në gjykatë, ose të paraqiten si prova.¹⁶

¹² Kërkesa e Parë, para. 1, 20.

¹³ Kërkesa e Parë, para. 1-2, 7-16.

¹⁴ Përgjigjja e Parë, para. 1, 6.

¹⁵ Përgjigjja e Parë, para. 1.

¹⁶ Përgjigjja e Parë, para. 1-2.

B. KËRKESA E DYTË DHE PËRGJIGJJA E DYTË

13. Në Kërkesën e Dytë, të dorëzuar pas seancës përgatitore të W04846-ës dhe para dëshmisë së tij në gjyq, Mbrojtja e Selimit i kërkoi Trupit Gjykses: (i) t'i tërhiqte vërejtje ZPS-së që gjatë seancave përgatitore me dëshmitarë, të respektonte Urdhrin dhe të mos kryente veprime që mund të përbënin udhëzim, mësim ose ushtrim të dëshmitarëve lidhur me dëshmitë e tyre; dhe (ii) të mbante parasysh ndikimin që sjellja e ZPS-së kishte shkaktuar në dëshminë e W04846-ës, kur të vlerësonte peshën që do t'i jepet dëshmisë së W04846-ës.¹⁷ Mbrojtja e Selimit pretendoi se kjo ishte e domosdoshme, pasi, sipas shënimit të ZPS-së në lidhje me seancën përgatitore me W04846-ën, ZPS-ja e kishte kryer atë në një mënyrë që ishte në kundërshtim me paragrafët 87 dhe 98(i) të Urdhrit,¹⁸ dhe kishte krijuar rrezikun e ndikimit në dëshminë e W04846-ës.¹⁹

14. ZPS-ja u përgjigj se Trupi Gjykses duhej ta rrëzonte Kërkesën e Dytë, pasi ajo shtrembëronte informacionin e dhënë në shënimin përgatitor.²⁰ ZPS-ja argumentoi se gjatë seancës përgatitore nuk kishte ndikuar në W04846-ën, dhe se kishte vepruar në përputhje me Urdhrin dhe Vendimin e Dytë.²¹ ZPS-ja parashtroi se, gjatë seancës përgatitore, asaj mund t'i duhet të sqarojë me dëshmitarin pjesët e provave të dëshmitarit që janë relevante dhe ato që nuk janë relevante, për të siguruar që dëshmitari të japë dëshmi relevante, të saktë dhe të strukturuar.²² Në rrethanat aktuale, ZPS-ja pretendoi se duhej t'i shpjegonte W04846-ës se Trupi Gjykses kishte përjashtuar pjesë të provave të tij dhe t'i tregonte pjesët për të cilat ende mund të dëshmonte.²³

¹⁷ Kërkesa e Dytë, para. 1-2, 9.

¹⁸ Kërkesa e Dytë, para. 3-5.

¹⁹ Kërkesa e Dytë, para. 6-7.

²⁰ Përgjigjja e Dytë, para. 1, 8.

²¹ Përgjigjja e Dytë, para. 1-2, 5.

²² Përgjigjja e Dytë, para. 1-3, 5.

²³ Përgjigjja e Dytë, para. 3-4.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

15. Sipas nenit 40(2), trupi gjykues siguron që shqyrtimi gjyqësor të jetë i drejtë dhe i shpejtë dhe që procedurat të zhvillohen në pajtim me Rregulloren, në respekt të plotë të drejtave të akuzuarit dhe duke i kushtuar kujdesin e duhur mbrojtjes së viktimave dhe dëshmitarëve.

16. Sipas rregullës 116(1), trupi gjykues merr vazhdimisht të gjitha masat dhe miraton procedurat e nevojshme për lehtësimin e kryerjes së drejtë e të shpejtë të gjykimit.

17. Brenda kornizës së Ligjit dhe Rregullores, paragrafët 85 dhe 99 të urdhrit rregullojnë takimet përgatitore me dëshmitarët në kuadër të këtij procesi.

IV. DISKUTIM

A. KËRKESA E PARË

18. Argumenti i Mbrojtjes së Selimit se gjatë seancës përgatitore, ZPS-ja nuk mund t'i tregojë dëshmitarit një deklaratë të mëparshme që nuk është në listën e provave materiale,²⁴ është i pabazë dhe në kundërshtim me kushtet e Urdhrit. Në paragrafin 97(iii) të Urdhrit konkretisht thuhet: “gjatë seancave përgatitore, avokati që parashtron pyetje duhet: [...] t'i japë dëshmitarit mundësinë t'i shikojë deklaratat e mëparshme të veta”. Kjo bëhet për të siguruar që dëshmitarët të kenë mundësi të arsyeshme për t'u njohur me deklaratat e tyre të mëparshme para se të fillojnë dhënien e dëshmisë, dhe kjo bëhet pavarësisht nëse dëshmitari do të dëshmojë tërësisht gojarisht apo sipas rregullës 154. Ky proces i njohjes së dëshmitarit me deklaratat e veta të mëparshme është në përputhje me qëllimin e përgatitjes së dëshmitarit, që, sipas Urdhrit, është “të sigurojë që dëshmitari jep dëshmi që lidhet me lëndën, të saktë dhe të strukturuar”²⁵ dhe “të mundësojë

²⁴ Kërkesa e Parë, para. 2, 7-13.

²⁵ Urdhri, para. 86(i)(a).

marrjen në pyetje të dëshmitarit gjatë procesit në mënyrë të përqendruar, efikase dhe efektive”.²⁶

19. Procesi i njohjes së dëshmitarit me deklaratat e veta të mëparshme në kuadër të seancës përgatitore - gjatë së cilës ZPS-ja duhet t’i tregojë dëshmitarit të gjitha deklaratat e mëparshme të tij – është i ndryshëm nga dëshmia që dëshmitari jep në gjyq, ku ZPS-ja mund të paraqesë si prova vetëm deklarata të dëshmitarit që janë të përfshira në listën e provave materiale. Në qoftë se dëshiron të paraqesë si provë një deklaratë që nuk është në listën e provave materiale, ZPS-ja paraprakisht duhet të kërkojë leje për përfshirjen e asaj deklarate në listën e provave materiale.²⁷

20. Në rastin në fjalë, ZPS-ja nuk shprehu synimin për të paraqitur si prova deklaratat e mëparshme të dëshmitarit, e as për të marrë prej tij prova që Trupi Gjykses i kishte përjashtuar në Vendimin e Dytë. Nuk ka asgjë të palejueshme në faktin se gjatë seancës përgatitore, ZPS-ja i tregoi dëshmitarit deklaratat e tij të mëparshme, përfshirë ato që nuk janë në listën e provave materiale të ZPS-së.

21. Argumenti i Mbrojtjes së Selimit se ZPS-ja duhej t’i kishte redaktuar pretendimet në deklaratat e mëparshme të W04846-ës para se t’ia tregonte gjatë seancës përgatitore,²⁸ është gjithashtu i pathemeltë. Së pari, siç u përmend, në paragrafin 97(iii) të Urdhrit kërkohet shprehimisht që pala thirrëse t’i japë dëshmitarit mundësinë t’i shikojë të gjitha deklaratat e veta të mëparshme. Së dyti, ZPS-ja synonte ta thërriste W04846-ën për të dhënë dëshmi gojore dhe nuk synonte të paraqiste për pranim si provë ndonjë pjesë të deklaratave të tij të mëparshme, e aq më pak pjesën e kundërshtuar.²⁹ Rrjedhimisht, Mbrojtja nuk ka vërtetuar bazën mbi të cilën duhej të ishte redaktuar pjesa e kundërshtuar para se dëshmitarit t’i tregohej deklarata gjatë përgatitjes për dëshminë e tij. Së treti, që të mundësonte “marrjen në pyetje [...] në mënyrë të përqendruar, efikase dhe efektive” të W04846-

²⁶ Urdhri, para. 86(ii).

²⁷ Rregulla 118(2).

²⁸ Kërkesa e Parë, para. 2, 14-16.

²⁹ *Shih më lart*, poshtëshënimin 1.

ës,³⁰ ZPS-ja duhej t'i shpjegonte W04846-ës Vendimin e Dytë, si dhe çfarë dëshmie i lejohej dhe nuk i lejohej të jepte. Për ta lehtësuar këtë proces, ishte logjike që ZPS-ja t'i tregonte W04846-ës deklaratat e tij të mëparshme në formë të paredaktuar. Së katërti, ishte e arsyeshme që dëshmitarit t'i tregoheshin deklaratat e mëparshme në formë të paredaktuar, për t'i mundësuar ZPS-së ta paralajmëronte efektivisht W04846-ën që të mos jepte vullnetarisht dëshmi në lidhje me pretendimet.

B. KËRKESA E DYTË

22. Mbrojtja e Selimit pretendon se fakti që avokati që parashtrroi pyetjet bëri të ditur se: (i) "kishte ende prova të rëndësishme që W04846 mund t'i jepte Trupit Gjykues", veçanërisht në lidhje me një incident ku pretendohet se kishte qenë i përfshirë z. Selimi ("komenti i parë"); dhe (ii) illustroi me shembull se dëshmia e W04846-ës ishte "e rëndësishme dhe pjesë e një enigme më të madhe", duke iu referuar konkretisht përpjekjeve të një të afërmi për të liruar një person tjetër nga mbajtja në ndalim prej UÇK-së ("komenti i dytë") – përbënte sjellje që bie ndesh me paragrafët 87 dhe 98(i) të Urdhrit.³¹

23. Në paragrafin 87 të Urdhrit thuhet se "ndalohet çdo tentim për të ndikuar tek dëshmitari që të japë dëshmi për ngjarje faktike të cilat nuk i ka parë ose nuk i ka perceptuar. Nuk lejohen udhëzimi, mësimi ose ushtrimi".

24. Në paragrafin 98(i) të Urdhrit gjithashtu thuhet se:

98. Gjatë seancave përgatitore, avokati që merr në pyetje:

i. nuk tenton të ndikojë në thelbin e përgjigjeve të dëshmitarit, drejtpërdrejt ose tërthorazi (për shembull, ndër të tjera, të informojë dëshmitarin lidhur me llojin e provave që do të ndihmonin argumentet e palës thirrëse, të sugjerojë nëse përgjigjet e dëshmitarit janë me vend apo jo, ose t'i bëjë dëshmitarit pyetje sugjeruese të papërshtatshme [...]).

³⁰ Urdhri, para. 86(ii).

³¹ Kërkesa e Dytë, para. 4

25. Trupi Gjykses gjykon se gjatë seancës përgatitore të W04846-ës, ZPS-ja u soll në përrputhje me Urdhrin. Trupi Gjykses pranon shpjegimin e ZPS-së se, kur iu shpjeguan kufizimet e vendosura me Vendimin e Dytë, dëshmitari mendoi seriozisht që të mos jepte më dëshmi, dhe nuk e kuptonte se pse nuk mund të fliste për një pjesë të provave të tij që “lidhej me pjesën tjetër të provave të tij”.³²

26. Nga shënimi i seancës përgatitore duket qartë se, pasi i shpjegoi W04846-ës se Trupi Gjykses kishte përjashtuar paraqitjen e provave nga ZPS-ja dhe të dëshmisë gojore të W04846-ës në lidhje me pretendimet në fjalë, ZPS-ja bëri komentin e parë për t’i shpjeguar W04846-ës se kishte ende prova relevante që mund t’i jepte Trupit Gjykses.³³ Duke qenë se Trupi Gjykses kishte përjashtuar një pjesë të konsiderueshme të provave të propozuara të dëshmitarit, Trupi Gjykses vlerëson se ishte e arsyeshme që dëshmitarit t’i shpjegohej se kishte ende prova të rëndësishme që i lejohej t’i jepte. Mënyra se si kjo u bë, nuk ishte e paarsyeshme ose e padrejtë.

27. Nga shënimi i seancës përgatitore gjithashtu del qartë se ZPS-ja bëri komentin e dytë në përgjigje të zhgënjimit që shprehu W04846 për faktin se nuk do të mund të dëshmonte në lidhje me pretendimin e parë, dhe për të shpjeguar se dëshmitari ende mund të dëshmonte në lidhje me jetën e një të afërmi.³⁴ Nuk ka tregues se ZPS-ja tentoi të ndikonte te W04846 që ky të dëshmonte për ngjarje faktike të cilat nuk i kishte parë,³⁵ apo të ndikonte në thelbin e përgjigjeve të W04846-ës.³⁶

28. Meqenëse Trupi Gjykses vlerëson se sjellja e ZPS-së gjatë seancës përgatitore ishte në përrputhje me Urdhrin, nuk pati nevojë që ZPS-së t’i tërhiqej vërejtje.³⁷ Nuk është e nevojshme as “të merret parasysh ndikimi i shkaktuar nga sjellja e ZPS-së”

³² Përgjigjja e Dytë, para. 3.

³³ *Shih* 121715-121728, para. 9.

³⁴ *Shih* 121715-121728, para. 12.

³⁵ Urdhri, para. 87.

³⁶ Urdhri, para. 98(i).

³⁷ Kërkesa e Dytë, para. 2, 9.

gjatë vlerësimit të peshës që do t'u jepet provave të W04846-ës, siç kërkon Mbrojtja e Selimit.³⁸ Trupi Gjykses, në përputhje me rregullën 139(2), do t'i vlerësojë provat duke mbajtur parasysh tërësinë e provave të administruara në gjykim.

V. KLASIFIKIMI

29. Trupi Gjykses vëren se Përgjigja e Parë është dorëzuar si konfidenciale. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses urdhëron ZPS-në që të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Përgjigjes së Parë, ose të kërkojë riklasifikimin e Përgjigjes së Parë, jo më vonë se **të enjten, 19 shtator 2024**.

VI. VENDIM

30. Për këto arsye, Trupi Gjykses:

- a) **RRËZOI** Kërkesën e Parë dhe Kërkesën e Dytë; dhe
- b) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Përgjigjes së Parë, ose të kërkojë riklasifikimin e Përgjigjes së Parë, jo më vonë se **të enjten, 19 shtator 2024**.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E enjte, 12 shtator 2024

Në Hagë, Holandë.

³⁸ Kërkesa e Dytë, para. 2, 9.